



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, duke vendosur sipas kërkesës së Latif Smajlit nga Bregu i Zi, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE**

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 1500 € (një mijë e pesëqind euro), Latif Smajlit nga Bregu i Zi për trajtim mjekësor të vëllaut Sejdi Smajli sipas kërkesës së tij të datës 12.05.2020, për të cilin ka filluar një aksion vullnetar nga ana e të gjitha fshtarave dhe është publikuar edhe një mjetet e komunikimit publik pasi trajtimi i sëmundjes së tij është shumë i shtenjtë dhe i papërbalueshëm për familjen.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në xhironlogarinë bankare 1401000014089526 në Bankën Ekonomike.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Latif Smajli nga Bregu i Zi.

1Nr. 400-17808
Lipjan, më 12.05.2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

